



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16057 Prot.

Lezhë, më 2 . 11 . 2023

VENDIM

Nr. 62, Datë 31. 10. 2023

PËR

**DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET.**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr.8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", VKM nr. 433 datë 08.06.2016 e ndryshuar me VKM nr 684 datë 02.09.2020 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave e Bashkive", VKM nr. 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar, në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, date 9.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjekte të ndryshme për marrje toke pyjore në përdorim, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

**Vendosi:**

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore prej **2.5 ha + 0.5 km** rrugë auto ekzistuese, në parcelën pyjore **104** brenda Ekonomisë Pyjore "Brinjat e Kreshtës", Njësia Administrative Ungrej, sipas Raportit Teknik bashkangjitur.
2. Afati për dhënie në përdorim do të jetë 10 vjet me të drejtë rinovimi.
3. Vlera fillestare e qirasë në vit, përfshirë edhe infrastrukturën ndihmëse do të jetë:
  - Për sipërfaqen pyjore për t`u dhënë në përdorim, 210000 lekë/ha.
  - Për rrugën auto për t`u dhënë në përdorim 70000 lekë/km.

4. Proçedura për dhënien në përdorim do të zhvillohet me garë të hapur sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Njësia e Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë.
6. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**NDUE LULI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 901/139 Prot.

Lezhë më 07.11.2023

**Lënda: Konfirmim vendimi**

**KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË**

**Për Dijeni : KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË**

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit Nr.107/2016 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", ligjin nr.139/2015 "Për vërtetësisht vendore", ligjin nr .8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", ligjin nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" të ndryshuar ; ligjin nr. 57/2020 datë 30.04.2020 "Për pyjet"; VKM-në nr. 433, datë 8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/ bashkive" të ndryshuar; ; VKM-në nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurës së mbledhjes së tyre (ndryshuar me VKM-në nr. 267, datë 27.4.2023) si dhe në Udhezimin nr. 1 date 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit "Për rregullat ,proçedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr. 62, datë 31.10.2023 të këshillit të bashkisë Lezhë "Për dhënie e dakortësisë për vijimin e proçedurave për dhënie në përdorim me kontrata qiraje të sipërfaqes së fondit pyjor në pronësi të bashkisë Lezhë , për ushtrimin e veprimtarive të parashikuara në legjislacionin në fuqi për pyjet".

**P R E F E K T I**

**Gjergj PRENDI**

